

PREFEKTURA E KUKËSIT.

Vështrim i shkurtër historik.

Fjala Prefekturë vjen nga latinishtja (prefectura), që do të thotë Autoritet Shtetëror, Udhëheqje, Administratë Qyteti, Njësi Territoriale. Me këtë termë quhet dhe ndërtesa ku është vendosur ky autoritet, kjo Administratë. Në kohën e pushtimit romak, Iliriku që përfshinte thuajse tërë Ballkanin ishte ndarë në njësi më të vogla Administrative që quheshin Prefektura.

Me këtë kuptim ky term u përdor në vendin tonë para çlirimit (para vitit 1944).

Sot Prefektura ka funksionin dhe kuptimin e Autoritetit Shtetëror që kontrollon ligjshmërinë e veprimtarisë të Qarkut dhe Organeve të tjera lokale, pra përfaqëson Autoritetin të cilit i janë deleguar kompetencat e Qeverisë në Nivel Qarku.

Në fillim , në Shtetin Shqiptar të sapoformuar, Prefekurat kanë përfaqësuar ndarjen më të madhe Administrative të vendit, që kishte si qendër një qytet kryesor. Së pari, kështu u nda Administrativisht Territori i Shtetit të ri Shqiptar, me statusin organik të vitit 1914, gjë që nuk funksionoi gjatë viteve të mëvonshme deri në vitin 1920, kur u mbledh “Kongresi historik i Lushnjës” i cili vuri themelet e shtetit modern shqiptar, për shkak të pushtimeve të njëpasnjëshme që kapluan Shqipërinë gjatë periudhës shumë komplekse të Luftës së Parë botërore.

Sipas ligjit mbi Administratën Civile të vitit 1928, gjatë periudhës së mbretit A. Zogu, Shqipëria u nda në 9 prefektura të pjesëtuara në 39 nënprefektura dhe këto të fundit në komuna njëra prej të cilave qe Prefektura e Kosovës, territori i sotëm i Prefekturës së Kukësit.

Në krye të çdo Prefekturë qëndronte **Prefekti** që emërohej nga mbreti. Të gjithë organet lokale, me përjashtim të atyre të ushtrisë dhe të drejtësisë, ishin nën vartësinë dhe kontrollin e drejtpërdrejtë të tij. Këtë kuptim, prefekurat dhe nënprefekurat e ruajtën deri në vitin 1949, vit kur u ligjërua ndarja e re administrative e territorit të Republikës së Shqipërisë...

Njëra prej 9 Prefekturave të Shqipërisë ka qenë Prefektura e Kosovës brenda së cilës përfshiheshin thuajse territoret e sotme të Prefekturës së Kukësit, duke përjashtuar zonën e Malziut (Shëmrisë) që deri në Maj të vitit 1945 ka qenë pjesë e Nënprefekturës së Pukës dhe Prefekturës së Shkodrës si dhe Kalasë së Dodës që iu hoq asaj , në vitin 1952, për t'i kaluar Qarkut të Dibrës.

Fillimet e Prefekturës së Kukësit i gjejmë përtej vitit 1921. Këtë vit u krijua Prefektura e Drinit me Qëndër në Peshkopi. Kjo njësi administrative përfshinte brenda saj Territoret e Rrethit të Kukësit deri tek Drini i Bardhë në Veri.

Pas largimit të forcave pushtuese jugosllave nga territoret në veri të Drinit dhe lindje të Drinit të Zi , në vitin 1922 u krijua Prefektura e Kosovës me qendër Krumën. Brenda saj u përfshin territoret e sotme të qarkut të Kukësit, pra rrethet Kukës ,Has, dhe Bajram Curri me dy Nënprefektura : Lumën me qendër Bicajt dhe Tropojën me qendër Kolgecajt.

Lidhur me rrethanat dhe arsyet e emërtimit të kësaj Prefekturë me emrin ‘Kosova’ nuk ka ndonjë të dhënë të sigurtë. Megjithatë motivi politik patriotik , për të nënvijëzuar ndarjen e padrejtë të Kosovës nga shteti shqiptar dhe unitetin natyror të këtyre dy anëve të kufirit,duhet t’i ketë udhehequr ata që vendosën për ta quajtur kështu. Nuk duhet të harrojmë faktin se nga të gjithë pikëpamjet gjeografike ,historike ekonomike dhe kulturore,territori i Prefekturës së Kukësit nuk është tjetër pos vijim e pjesë e Kosovës.

Këtu duhet të kemi parasysh dhe realitetin e pjesëmarrjes të shumë patriotëve të shquar kosovarë në Organet Vendim-marrëse të Shtetit Shqiptar në të gjithë nivelet e pushteteve të asaj kohe. Mendojmë se duhet marrë në konsideratë dhe e vërteta se deri në këtë kohe emri i Kukësit ishte i panjohur siç ishte ai i Kosovës.

Në shkurt të vitit 1925, pas trazirave të vitit 1924, periudhe e emëruar nga historiografia shqiptare “Revolucion demokratiko-borgjez” dhe për shkak të pozicionit gjeografik të favorshëm, me gjithë kundërshtimin e deputetëve të kësaj Prefekturë në Asamblenë Kushtetuese,me vendim të Qeverisë Shqiptare qendra e Prefekturës së Kosovës (Prefektura e sotme e Kukësit) u transferua nga Kruma në fshatin Kukës,deri atëhere qendër krahinarie që nuk i arrinte të 200 banorët. Nga dokumentet mësojmë se transferimi u realizua vetëm pas muajit gusht të atij viti, kohë kur duket se u krijuan kushtet minimale për këtë gjë. Kjo kohë shënon dhe fillimet e jetës së një Qyteti të ri në Shtetin Shqiptar, të Qyteti të Kukësit.

Që në mars të vitit 1943, në zonën e Hasit , në territorin e sotëm të Prefekturës së Kosovës (Kukësit), nga ana e formacioneve partizane filluan të ngriheshin këshillat nacionalçlirimtare të fshatrave,proces që u realizua qartë me 25 korrikun e vitit 1944, kur në fshatin Gjabricë u krijua Këshilli Nacionalçlirimtar për krahinën e Lumës.

Me gjithë keto zhvillime ,që në njëfarë mënyre pas shtatorit të vitit 1944, cuan në krijimin e pushteteve paralele ose në disa zona menjanimin e pushteteve të mëparshme, duke thënë se Prefektura si njesi Administrative, në mos në të gjithë territorin në pjesët me vitale të tij , me gjithë funksionet e saj ose me disa prej funksioneve kryesore vazhdoi që të qëndronte deri ne krijimin e Këshillave Nacional-Çlirimtare të Qarqeve.

Kurse në kuptimin e ndarjes territoriale të vendit, ajo vazhdoi edhe më vonë. Kjo mund të thuhet edhe për Prefekturën e Kukësit e cila në kuptimin e saj te mirëfillte funksionoi deri ne shtatorin e vitit 1944, ndërsa në kuptimin e ndarjes territoriale deri në vitin 1949.

Në Bicaj pushon së funksionuari Nën-Prefektura dhe funksionet e saj pasi në shtatorin e vitit 1944 u formua Këshilli Nacional-Çlirimtar provizor i Qarkut që zëvendësoi të gjitha funksionet e ish Prefekturës, të paktën në ato zona që ishin në duart e pushtetit të Frontit Nacional-Çlirimtar.

Komunat ,njësite më të vogla, filluan të emertoheshin krahinë dhe këshillat komunal me “Këshilli Nacionalçlirimtar krahinor”. Kjo gjendje vijoi deri në dhjetorin e vitit 1944, kur u zgjodh Këshilli Nacional-Çlirimtar definitiv i qarkut Kukës i cili u instalua në qytetin e Kukësit, në godinën e ish Prefekturës.

Me këtë rast, nderkohe që nderroi natyrën e pushtetit , nga pikepamja territoriale qarku mbeti në kufijtë e ish Prefekturës së Kosovës.

Në vitin 1946 nga 2 Nënprefektura që ishin atëherë (Luma dhe Tropoja) ish Prefektura e Kukësit u bë me 3. U formua dhe Nënprefektura e Kukësit ose e qendrës.

Në vitin 1949 u bë ndarje e re administrative në Shqipëri. Nga praktikën e ndarjes territoriale administrative të vendit hiqet dorë emërtimi Prefekturë si territor dhe si funksion , për rrjedhojë edhe nga Nënprefektura dhe Komuna . Vihen në jetë Rrethet dhe Lokalitetet , me sa duket një përvojë lindore.

Ish Prefektura e Kosovës, e quajtur edhe Qarku i Kukësit u nda në 2 rrethë: Kukës me qendër qytetin e Kukësit dhe Tropojë me qendër Kolgecaj (sot qyteti i Bajram Currit) .

Brenda rrethit të Kukësit u përfshinë përveç territorit të sotëm të Kukësit edhe Hasi,Fani (1978 shkëputet nga Kukësi), Dardha e Pukës (1952 shkëputet nga Kukësi) dhe Kalaja e Dodës (1952 shkëputet nga Kukësi). Brenda rrethit të Tropojës mbeti hapsira e territorit të sotëm të rrethit Bajram Curri.

Kjo ndarje qëndroi deri në vitin 1953, kur u bë ndarja e re tokësore administrative e Shqipërisë. Njësia më e madhe u bë qarku.Qarqet ndaheshin në rrethë ,rrethet në lokalitete dhe këta të fundit në fshatra. Me këtë rast u formua Qarku i Kukësit në territorin e Prefekturës së Kosovës, me rrethet Lumë, Bajram Curri e qendrën Kukës.

Në vitin 1955, u suprimua Qarku si njësi dhe funksion Administrativ. Rrethi mbeti njësia më e madhe Administrative në Shtetin Shqiptar. Në Kukës mbeten dy rrethë: Kukësi ku përfshihen ish rrethi i Lumës, Hasi,lokaliteti i qendrës bashkë me Fanin si dhe Bajram Curri në territoret e sotme të tij.Përveç ndryshimit të vitit 1979, kur rrethet në vend të lokaliteteve u ndanë në njësi më të vogla, në këshillat e bashkuar kjo deri në vitin 1992.

Së pari ky vit rezultoi me ndarjen e Hasit nga Kukësi dhe formimin e rrethit të Hasit me qendër qytetin e Krumës. Pra ndarjen e territorit të ish Prefekturës së Kosovës apo të Qarkut të Kukësit të rrethëve Kukës, Has , dhe Bajram Curri. Menjëherë pas zgjedhjeve lokale të korrikut të vitit 1992, u hodhë idea e formimit të Prefekturave duke u riformuar

Prefektura e Kukësit në territorin e Prefekturës së dikurshme të Kosovës, me qendër në Qytetin e Kukësit, por tani me kuptim e funksion të ri.

Në vitin 1932 ajo vendoset në ndërtesën e saj të re në Kukës, ish godina e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Kukësit, më e mira për një kohë të gjatë nga të gjitha pikëpamjet.

Pas riformimit (1993) prefektura u vendos në dy zyra të Godinës aktuale të Qarkut dhe që prej vitit 1996 në katin e dytë dhe një pjesë e katit të parë të ish Hotel-Turizmit Gjallica, ku vazhdon punën dhe veprimtarinë e saj edhe sot.

Emrat e Prefektëve të Prefekturës së Kukësit ndër vite:

1. Brahim Gjakova 1922
2. Hasan Kryeziu 1925
3. Rrok Perolli pas vitit 1939
4. Selman Agolli pas ringritjes së Prefekturës në Vitin 1993
5. Xhovalin Bzheta 1996
6. Qemal Elezi 1997
7. Shaqir Shehu 2002
8. Qamil Cenalia 2005
9. Lulzim Aliaj 2009-2009
10. Elez Maçi 2009-2013
11. Ram Hoxha 2013-2014
12. Safet Gjici 2014-2015
13. Liman Morina 2015 >